


Buletini i NFFIS dhe ECO-DRR për Ballkanin Perëndimor Projekti për Ndërtimin e kapaciteteve për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat përmes Sistemit Kombëtar të Informimit për Zjarret Pyjore (NFFIS) dhe Eco-DRR Mars 2021 - Shkurt 2026

Projekti për Ndërtimin e Kapaciteteve për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat përmes Sistemit Kombëtar të Informimit për Zjarret Pyjore (NFFIS) dhe Eco-DRR



Qëllimi i këtij projekti është të fuqizojë kapacitetet e zyrtarëve qeveritarë në parandalimin dhe zbutjen e zjarreve pyjore dhe katastrofave të tjera natyrore përmes krijimit të NFFIS dhe Eco-DRR.



NFFIS Ver1: Përfundimi dhe publikimi i versionit publik

NFFIS ka filluar të operojë si në Kosovë ashtu edhe në Mal të Zi. Verën e kaluar ishte hera e parë për NFFIS ofroi paralajmërimin e hershëm dhe informacionet për zjarre u mbledhën gjatë një sezoni zjarresh. Edhe pse nuk kishte probleme me funksionimin e vetë sistemit, duke qenë se kjo ishte hera e parë e funksionimit, u gjetën disa pika përmirësimi me analizën e të dhënave dhe inventarizimin. Bazuar në këtë eksperiencë, tashmë ka nisur puna për përmirësimin e NFFIS. Gjithashtu, do të vazhdojnë përpjekjet e mëposhtme për zgjerimin e sistemit dhe operimit:

1. përgatitjet për inkorporimin e funksionimit të NFFIS në akte nënligjore,
2. ndarjen e të dhënave të stacioneve automatike meteorologjike (AWS) nga tre shtetet, Kosova, Mali i Zi, dhe Maqedonia e Veriut për të përmirësuar saktësinë e analizave,
3. mbledhjen dhe sigurimin e të dhënave në lidhje me fatkeqësitë tjera natyrore përveç zjarreve në pyje, etj.



NFFISver1.1
(Majtë: Kosovë, Djathtë: Mali i Zi)

Aktivitetet e Eco-grupit

Projekti, i cili promovon zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, fokusohet gjithashtu në ndërgjegjësimin e publikut dhe edukimin mjedisor. Si një nga aktivitetet tona specifike, Projekti mbështet aktivitetet e grupeve ekologjike. Grupi ekologjik synon të përmirësojë cilësinë e jetës në shoqëri përmes aktiviteteve sociale dhe diskutimit të çështjeve.

Fillimisht, shkolla fillore në fshatin Restelice nuk kishte Grup ekologjik, por Projekti mbështeti formimin e Eko-grupit. Në ditën e mbjelljes në shtator, anëtarët e grupit zhvilluan një skeç rreth mbrojtjes së mjedisit. Në Istog, ekspertët i shpjeguan grupit të Eko-grupit që tashmë ka qenë aktiv në shkollën e mesme për erërat dhe Eco-DRR, dhe më pas krijuan një terrarium për të treguar vizualisht efektet e dëmeve nga erërat dhe thyerjen e erës. Në Ulqin, nxënësit nga secila shkollë që morën pjesë në edukimin mjedisor të udhëhequr nga projekti zhvilluan Eko-grup dhe morën pjesë në aktivitetet e mbjelljes së pyjeve bregdetare. Në vitin 2024 do të zhvillohen aktivitete të ndryshme në pyllin bregdetar në bashkëpunim me komunën dhe organizatat të tjera..



Mbjellja me grupin ekologjik në Ulqin



Pyjet për Mbrojtje nga Erërat -Istog



Dëmtimet nga erërat janë fatkeqësitë më të rënda natyrore në Istog, dhe problemi është bërë më serioz që nga viti 2000. Pra, ka probleme akute për të bërë planifikimin urban që adreson dëmtimet e erës, si dhe mirëmbajtjen dhe menaxhimin e shëndetshëm të pyjeve që kanë efektin e zbutjes së dëmeve nga era. Në bazë të këtij sfondi, lloji i duhur për të mbjellë është pisha e zezë, e cila në vend njihet si rezistente ndaj dëmtimeve të erës, dhe u mbollën pas matjes së distancës dhe sipërfaqes në tri shkolla në komunën e Istogut. Për më tepër, ne bëmë anketimin për të identifikuar llojet e peizazhit të prekur nga era, siç janë pyjet, dhe për të sqaruar problemet ose pengesat në restaurim dhe për të zhvilluar zgjidhjet për restaurimin.

Më 17 nëntor 2023, në prani të kryetarit të komunës së Istogut u shënua dita e Mbjelljes. Përveç mbjelljes së drunjëve, në këtë ditë u shfaqen 1) Demonstrim mbi rezistencën ndaj erës duke krijuar një terrarium, 2) Shpjegim dhe shfaqje të llojeve të drunjëve të mbjellë, dhe 3) Prezantim të kulturës dhe traditave të pasura të Istogut. Zhvillimet e ardhshme do të përfshijnë shtrirjen e aktiviteteve të kryera këtë vit në shkollat e tjera, krijimin e një doracakut të mbrojtjes nga era dhe përfshirjen e aktiviteteve të mbrojtjes nga era në planifikimin urban të Komunës së Istogut.



Foto e majtë: Shpjegimi për erërat nga nxënësit e shkollave të mesme të veshur me kostume tradicionale, Foto lartë: Ceremonia e mbjelljes së drunjëve (mbjellja e drunjëve nga kryetari i komunës së Istogut)



Restaurimi i Bimësisë pas zjarrit (RBPZ) në Kolashin



Në Mal të Zi, zona e zjarreve në pyje po rritet nga viti në vit. Meqenëse braktisja e vendeve pas zjarrit mund të shkaktojë fatkeqësi të tjera dhe dëmtime dytësore, sfida është krijimi i një sistemi teknik efektiv për të promovuar rikuperimin e bimësisë sa më shpejt të jetë e mundur.

Si pjesë e teknologjisë për Eco-DRR, aktivitetet lidhur me RBPZ janë iniciuar në komunën e Kolashinit vitin e kaluar. Përveç mbjelljes së fidanëve të bredhit dhe pishës së zezë, u ndërmorën edhe këto aktivitete të tjera: i) masat e kontrollit të erozionit të tokës duke përdorur lisa dhe degë, dhe ii) përkrahja në rigjenerimin natyror (PRN) duke çliruar rigjeneruesit (pastrimi i bimësisë së panevojshme), pasurimi i mbjelljes (mbjellje në zona me më pak rigjenerim të fidaneve të reja) dhe gërryerja e tokës (grumbullim i shtresës së humusit dhe dherave të tjera që pengojnë rritjen e fidaneve të reja).

Në veçanti, meqenëse ka pak shembuj të PRN në të kaluarën në vend, u vendos që tani e tutje të krijohen parcela studimi dhe të kryhen studime të rregullta të vegjetacionit. Nëse arrihen rezultate, metodat pritet të përdoren si një teknikë me kosto të ulët për Eco-DRR.



Më lartë: Kontrolli i rrëshqitjes së dheut me degë
Më poshtë: ANR (Mbjellje me plehërim)

Përmbledhja e aktiviteteve

Kosovë/Mal i Zi Rezultati 1

- Fillimi i operimit të NFFISver1.1
- Përfundimi i verzionit publik NFFIS
- Përgatitja e udhëzuesit dhe PSO për NFFIS

(Procedura Standarde e Operimit)

Kosovë Rezultati 2

- Mbjellje shtesë për pyjet mbrojtëse nga orteku
- Aktivitete për mbrojtje nga erërat

Mal i Zi Rezultati 2

- Mbjellur afërsisht 2,300 fidane në Ulqin
- Zbatuar aktivitete për restaurimin e bimësisë pas Zjarrit



Ju lutem na ndiqni!

Faqja eFacebook e Projektit
<https://www.facebook.com/WestBalkanNFFISandEcoDRRProject>



Ministria e Punëve të Brendshme (MIA) - Agjencia për Menaxhimin e Emerxhencave (AME)



Ministria e Brendshme(MB)- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH)



Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA)